

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dosti për vendimin e Hagës: 81 vite burg për krerët e UÇK-së, por lufta dhe përgjegjësia individuale nuk janë e njëjta gjë
ADRESA	https://albeu.com/kosove/dosti-per-vendimin-e-hages-81-vite-burg-per-kreret-e-uck-se-por-lufta-dhe-pergjegjesia-individuale-nuk-jane-e-njejta-gje/1014169/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:48:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:46:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d7f70d56ff4129e51246efc8dbfae5b0943508a3d1b88caf36cc77888047c33f
TEKSTI	6dca81821395d97f2e0b6183a9c95a9d41e2f7c729233a7bcc56752687d6c5fb
PAMJA	938cc412d84185d6e09414c2926a4edfdb530a8fc62e73bc69a70ed47a223d79

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2d613f5a8195c3de5d91aa1128edecb2f4786fd384986290d8c33ab23da09de5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2d613f5a8195c3de5d91aa1128edecb2f4786fd384986290d8c33ab23da09de5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dosti për vendimin e Hagës: 81 vite burg për krerët e UÇK-së, por lufta dhe përgjegjësia individuale nuk janë e njëjta gjë



Publicisti Adriatik Riza Dosti ka reaguar pas vendimit përfundimtar të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Të katër të akuzuarit u dënuan në total me 81 vjet burgim, vendim që Dosti e cilëson si të rëndë.

Sipas tij, përgjegjësia për krimet duhet të trajtohet veçmas nga vlerësimi për luftën dhe karakterin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dosti rikujtoi edhe qëndrimin e gjyqtarit Charles L. Smith, i cili deklaroi se akuzat dhe dënimet lidhen me përgjegjësinë personale të të akuzuarve dhe jo me legjitimitetin apo veprimtarinë e UÇK-së.

Dosti ka thënë se e ka konsideruar Thaçin dhe Veselin fajtorë, por nuk ka pritur që ndaj tyre të shqiptoheshin dënime kaq të larta. Ndërsa për Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, ai ka deklaruar se ka pritur pafajësi, porçjell "Bota sot".

Shkrimi i plotë

Dhomat e Specializuara në Hagë shpallën vendimin përfundimtar: Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet, Jakup Krasniqi me 25 vjet dhe Rexhep Selimi me 13 vjet, gjithsej 81 vite.

Bëhet fjalë për masa të rënda dënimi.

Gjatë leximit të vendimit, gjyqtari Charles L. Smith sqaroi se akuzat dhe dënimet nuk lidhen me legjitimitetin e UÇK-së apo me veprimtarinë e saj, por me përgjegjësinë individuale të secilit të akuzuar.

Sipas Dosit, ata përfunduan vetë në kurthin që kishin ngritur, pasi besuan se në të do të binin të tjerë dhe votuan e miratuan krijimin e Gjykatës Speciale.

të fundit /



Stellantis zbulon BOW, furgonin autonom elektrik të ndërtuar si...



Dosti për vendimin e Hagës: 81 vite burg për krerët e UÇK-së, por...



Pas aktgjykimit në Hagë, protestuesit nga qendra e Prishtinës...



Kontrolle policore në Bërnjarcë, sekuestrohen drogë...



Dënimi me 81 vite burg për ish-drejtesit e UÇK-së/ Bardhi: Një...



PDK kundërshton aktgjykimin ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe...



Lladrovci: Aktgjykimi ndaj ish-drejtesve të UÇK-së e shndërroi...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Askush, sipas tij, nuk mund ta njollosë UÇK-në dhe luftën e saj për çlirimin e Kosovës, por po ashtu askush nuk duhet të përdorë gjakun e saj për t'u mbrojtur apo për t'u fshehur.

Dosti shprehet se kushdo që ka kryer krime, qoftë gjatë luftës apo veçanërisht në periudhën e paqes, duhet të mbajë përgjegjësi dhe të dënohet.

Ai thekson se Haga duhet të bëjë dallimin mes njerëzve që luftojnë për lirinë e vendit dhe popullit të tyre, siç ishin shqiptarët e Kosovës, dhe atyre që, sipas tij, ishin pushtues, dhunues, grabitës, plaçkitës, kriminelë, përdhunues e sadistë që dogjën Kosovën dhe dëbuan popullsinë e saj nga trojet e veta; këta, sipas tij, ishin serbët.

"Drejtesi për të gjithë", shkruan Dosti, duke shtuar se nuk duhet të ketë kurrë barazi mes kriminelit dhe viktimës.

Pas shpalljes së vendimit nga Haga, ai pret reagime në Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare.

Dosti përsërit se personalisht ka besuar se Thaçi dhe Veseli janë fajtorë, por jo në atë masë sa të mermin dënime kaq të rënda.

Ndërkohë, për Krasniqin dhe Selimin, ai thotë se kishte pritur vendim pafajësie.

Megjithatë, publicisti thotë se mbetet dakord me deklaratën e gjyqtarit Charles L. Smith: UÇK-ja përfaqëson një çështje, ndërsa personat përgjegjës për krime përbëjnë një çështje tjetër.

Dosti u bën thirrje qytetarëve të Kosovës të përmbahen dhe ta gjykojnë situatën me qetësi e logjikë. Sipas tij, Haga nuk është "çmendur", por përgjegjës janë fajtorët, të cilët ai i quan edhe "vetë-dënues".

Ai shprehet se dëshiron të dëgjojë se çfarë do të deklarojë Rama, të cilin e cilëson si një nga personat kyç që i bindi Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe të tjerët për të votuar krijimin e Gjykatës Speciale.

Gjithashtu, Dosti pyet se çfarë do të thotë Baton Haxhiu, për të cilin pretendon se i futi ata në këtë kurth duke luajtur, sipas tij, lojën e Beogradit.

Ai kërkon të dijë edhe se çfarë do t'u thonë tani Albin Kurtit kundërshtarët më të fuqishëm të krijimit të kësaj gjykate, përfshirë Hamzat e PDK-së së tij, Ramushet e Gjinet, Isat e Dullat, Gashet e Lushtakët dhe të tjerë.

"Haga foli sot. Tani duhet të flasë edhe Prishtina, me mendje të kthjellët dhe në mënyrën që duhet, nga ky moment e tutje", përfundon Dosti.

Shtuar më 16.09.2026 12:46

Tags: Adriatik Riza Dosti , denime , Hagë , uck



Pas aktgjykimit në Hagë, protestuesit nga qendra e Prishtinës marshojnë drej...



Dënimi me 81 vite burg për ish-drejtesit e UÇK-së/ Bardhi: Një padrejtësi e...



PDK kundërshton aktgjykimin ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe...



Lladrovci: Aktgjykimi ndaj ish-drejtesve të UÇK-së e shndërroi drejtësinë në...



Haxhiu pas vendimit në Hagë: Një ditë e rëndë për Kosovën, historia e saj n...



Vëllai i Kadri Veselit: Procesi nuk ishte i drejtë, duhet ta pranojmë vendimin



Koci pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së: Procesi juridik nuk ka përfunduar



Ganiu Thaçi pas vendimit për Hashim Thaçin: Do të presim Apelin

